

FATMIRA MUSAJ

**VEPRIMTARIA E LEF NOSIT PËR PAVARËSINË
DHE KONSOLIDIMIN E SHTETIT SHQIPTAR**

Zgjedhja e Lef Nosit nga populli i Elbasanit, në krah të Dervish Bej Biçakut, Shefqet Daiut, Mit'hat Frashërit, etj., si delegat të këtij rrethi për në Kuvendin e Kombëtar të Vlorës, ishte rezultat i kontributit të tij të gjatë e shumëplanësh në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Veçanërisht pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, ku ashtu si shumë patriotë shqiptarë, edhe Nosi nuk do të pajtohej me politikën antishqiptare të turqve të rinj, që në thelb nuk ndryshonte nga ajo e sulltan Abdyl Hamitit. Formimi intelektual e bëri shumë shpejt atë të pranueshëm jo vetëm për figurat më të njohura të qytetit të Elbasanit, por edhe me elitën patriotike shqiptare në trevat e tjera të vendit. Duke përfituar nga klima e favorshme politike, ai kontribuoi në zhvillimin e lëvizjes arsimore, kulturore e patriotike në trevën e Elbasanit në vitet 1909-1912.

Zhvillimin e arsimit kombëtar, shkrimin e gjuhës shqipe mbështetur në një alfabet të unifikuar me germa latine, ai e konsideroi si një detyrë patriotike e cila do të ndikonte në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve, si dhe në rritjen e lëvizjes kombëtare të tyre. Me këtë shpjegohet edhe veprimtaria aktive e Lef Nosit, menjëherë pas Revolucionit Xhonturk. Në vitin 1909, ai themeloi në qytetin e Elbasanit klubin “Vllaznia” dhe shoqërinë “Afërdita” ku u zgjodh në drejtimin e tyre.¹ Në pozitat e anëtarit të klubit “Bashkimi” ai dha një kontribut të çmuar në mbarëvajtjen e aktivitetit të tij.² Pjesë e rëndësishme e kontributit në lëvizjen kulturore ishte angazhimi në çeljen e shkollave shqipe në qytet, ku vend të veçantë zë Normalja Kombëtare. Aty Lef Nosi ishte pjesë e stafit pedagogjik ku luajti rol në përgatitjen e brezave të tërë nxënësish, të cilët pas përfundimit të shkollimit, ktheheshin në trevat e

¹ Lef Nosi, *Dokumente Historike (1912-1918)*, përgatitur për botim nga Instituti i Historisë, Tiranë: “Nënë Tereza”, 2007, f.1.

² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 32, Dosja (më tej: D.) 7. Dëftesë për L.Nosin nga klubi “Bashkimi”, gusht 1908-1912.

tyre për përhapjen e zhvillimin e arsimit kombëtar shqiptar. Lëvizjen në fushën e kulturës, arsimit e propagandës, ai e pa të lidhur ngushtë dhe në shërbim të kërkesës themelore të Lëvizjes Kombëtare për çlirimin e formim të shtetit të pavarur. Kështu ai do të mbështesë fuqishëm lëvizjet kryengritëse të viteve 1910-1912 në Kosovë e më gjerë dhe programin politik të tyre. Në dokumente arkivore hidhet dritë mbi veprimtarinë e Lef Nosit në këtë drejtim. Në bashkëpunim me figura të tjera patriotike të qarkut të Elbasanit, ai luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e Kryengritjes së vitit 1912 në këto treva.

Krahas vendosjes së lidhjeve midis krahinave të ndryshme, ngritjes së çetave të armatosura dhe përpjekjeve për t'i pajisur me armë e municion, L. Nosi, Hasan Bej Biçaku, Ahmet Dakli, Irfan Bej Ohri, Axhah Beu, Ismail H. Tatzati, Asllan Shahini, Nexhip Haxhiademi, etj., që përbënin këshillin drejtues të kryengritjes për qarkun, vendosën lidhje dhe bashkëpunim me komitetet kryengritëse në Tiranë, Dibër, Durrës, Mat, Manastir, etj. Ata u përpoqën dhe ia dolën ta fusnin lëvizjen kryengritëse të qarkut të Elbasanit në shtratin e kryengritjes së përgjithshëm antiosmane me qendër në Kosovë, duke mbështetur veprimet luftarake të saj si dhe programin me kërkesë themelore, autonominë e Shqipërisë. Sukseset e kryengritësve shqiptarë e shtynë parinë e Kosovës që më 3 korrik 1912 t'i drejtojnë Portës së Lartë kërkesën për dorëheqjen e qeverisë, shpërndarjen e Parlamentit dhe zhvillimin e zgjedhjeve të reja. Me kërkesat e Prishtinës u solidarizuan edhe drejtuesit e komitetit të Elbasanit. Fitoret e kryengritësve në Kosovë e detyruan Portën e Lartë të ulej në bisedime me shqiptarët. Një delegacion qeveritar u dërgua për bisedime.

Në letrën që Irfan Ohri i dërgonte Lef Nosit, në fund të korrikut, i kërkonte që të bisedonte me A. Daklin për të organizuar një mbledhje në Kryezjarr, ku të përcaktonin qëndrimin e tyre në mbështetje të kërkesave të paraqitura nga kryengritësit e Kosovës para komisionit osman. Në të njëjtën kohë, L. Nosi mori një letër edhe nga Abdi Bej Toptani, i cili e njoftonte për organizimin e një mbledhje në Cërrik, zonë afër Elbasanit.³ Në këto momente para Hasan Prishinës, Ismail Qemal Vlorës, Luigj Gurakuqit, të cilët ishin truri i lëvizjeve politike të shqiptarëve, u shtrua detyra për të sensibilizuar të gjithë komitetet drejtuese të kryengritësve në

³ *AQSH*, F. 32, V. 1912, D. 132, fl. 53, 505; *po aty*, F. 32, V. 1912, D. 55, f. 109. Letër e Atai I Bokanik për Lef Nosin, Gjergjan, 11 korrik 1912.

vilajete të ndryshme shqiptare për të dalë para komisionit me një zë të përbashkët për të fituar autonominë territoriale administrative të Shqipërisë.

Falë dokumentacionit të ruajtur prej Lef Nosit, vërejmë se në përgjigje të thirrjes së H. Prishtinës, I. Qemalit, për të dërguar përfaqësuesit në Kosovë, për t'iu bashkuar programit kombëtar, Lef Nosi dhe drejtues të tjerë të kryengritjes në Elbasan, ashtu si komitetet e tjera të Shqipërisë së Mesme e të Jugut, me anë të një telegrami i kërkonin H. Prishtinës të pranonte *veçalatin* (përfaqësimin e tyre) dhe bënë me dije vendimin e tyre për të mbështetur 14 pikat e memorandumit që do t' i paraqiteshin Stambollit. Gjithashtu ata i kërkonin që t'ia bënte të njohura vendimet komitetit të Elbasanit.⁴

Me gjithë reduktimin e deformimin që Porta e Lartë u bëri 14 pikave të H. Prishtinës duke i hequr pikat më thelbësore, përkatësisht ato 2, 5, 11, Lef Nosi dhe drejtuesit e tjerë të komitetit të Elbasanit i kërkuan H. Prishtinës që të këmbëngulte që koncesionet e fituara, të zbatoheshin në të 4 vilajetet shqiptare.⁵ Dhe kështu ndodhi, Porta e Lartë pranoi që kërkesat e shqiptarëve të zbatoheshin në të katër vilajetet. Menjëherë me anën e një telegrami H. Prishtina kërkoi shpërndarjen e kryengritësve. Më 24 gusht, komiteti i Elbasanit organizoi në qendër të qytetit një pritje për kryengritësit e këtij rrethi.⁶ Komiteti drejtues i kryengritjes në Elbasan me mbështetjen e popullit bënë përpjekje për të realizuar vetëqeverisjen.⁷

Përhapja e kryengritjes dhe mbështetja e programit autonomist nga të gjitha krahinat shqiptare shqetësoi shtetet fqinjë. Krijimi i një shteti autonom shqiptar do të pengonte realizimin e planeve të tyre aneksioniste ndaj territoreve të vilajeteve të Rumelisë që në shumicë kishin popullsi shqiptare. Krahas presionit që Fuqitë e Mëdha mbështetëse të interesave të tyre, ushtronim mbi Portën e Lartë për të penguar njohjen e autonomisë së Shqipërisë, shtetet ballkanike të lidhura në aleanca politike dhe

⁴ *AQSH*, F. 32, V. 1912, D. 132, fl.174. Letër e L. Nosit nga Valëshi, 3 korrik 1912; *po aty*, F. 32, V.1912, D.55, fl.102. Dokumenti flet për levizjet e L. Nosit në Valesh dhe letërkëmbimin me Atai I Bokanik, për lëvizjen kryengritëse në Elbasan.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSSt.A.P.A.A.*) në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 22-68. Telegram i konsullit Halla në Manastir drejtuar Berthold-it, Manastir, 24 gusht 1912; *po aty*, Vj. 27-17-1777. Telegram nr.98, i konsullit Halla në Manastir drejtuar Pallavicinit në Stamboll, 28 gusht 1912.

⁷ *Po aty*.

ushtarake, nisën përgatitjet për luftë me Perandorinë Osmane. Ushtritë serbe e malazeze kishin filluar përpjekjet me armë në kufirin verior të vilajetit të Kosovës. Tek drejtuesit e komitetit të Elbasanit ndihej shqetësimi për situatën e re politike në të cilën gjendej vendi. Nuk kaloi gjatë dhe më 8 tetor 1912 shtetet ballkanike i shpallën luftë Perandorisë Osmane. Sulmet e ushtrive serbe e greke në territoret shqiptare vunë në rrezik unitetin e tyre. Para elitës politike shqiptare u shtrua si detyrë mbajtja e një kuvendi kombëtar për të diskutuar mbi të ardhmen politike të territoreve shqiptare, në ato momente kur shihej qartë se fundi i Perandorisë Osmane ishte i pashmangshëm.

Lajmi i organizimit të një kuvendi kombëtar edhe në Elbasan u mirëprit nga patriotët e këtij rrethi. Ndërkohë, me anë të letërkëmbimeve me patriotët në treva të ndryshme shqiptare, Lef Nosi shkëmbente mendime dhe informohej me të rejat rreth situatës së vështirë të krijuar në Shqipëri.

Në nëntor 1912, Musa Shqiptari, pasi e falënderonte Nosin për informacionin e dhënë mbi situatën në rrethin e Elbasanit, theksonte: “U gëzova që na kujton kur jemi në errësi, pra në mungesë të informacionit”. Gjithashtu ai e informonte Nosin për situatën e vështirë që ishte krijuar në rajonin e Vlorës, pas dy javë bllokadë të shkaktuar nga grekët, të cilët kishin shpëputur edhe linjën telegrafike. Gjithashtu ai e bën me dije, se më 29 të vjeshtës së dytë (11 nëntor 1912) i kishte dërguar Mihal Bicit një letër, me anën e së cilës kishte përcjellë një tjetër letër shkruar në turqisht për Hysen Efendi Hastopallin. Letra e dytë nuk ishte gjë tjetër veçse kopja e telegramit të I. Qemalit drejtuar qarqeve patriotike të Vlorës nga Vjena. Ai i sugjeronte L.Nosit që ta lexonin me kujdes, sepse “ka fjalë shumë të mëdha të një rëndësie të madhe në dobi të fatit të Shqipërisë.”⁸ Me anë të tij, I.Qemali njoftonte patriotët për mbërritjen në Shqipëri, sigurimin e mbështetjes ndërkombëtare dhe domosdoshmërinë e organizimit të një kuvendi kombëtar dhe bashkimit të të gjithë shqiptarëve, “pasha qoftë, bej, apo aga, mysliman apo të krishterë, të përpiqemi e të jemi gati për çdo nevojë.”⁹ Musa Shqiptari i kërkoi Lef Nosit që edhe në Elbasan të bashkëpunonin me njëri-tjetrin në mbështetje të kësaj lëvizje mbarë patriotike, ashtu siç po vepronin

⁸ *AQSH*, F. 32, V. 1912, D. 55/1, fl.161. Letër e Muç Shqiptarit drejtuar Nosit, Vlorë, 1 vjeshtë e tretë 1912.

⁹ *Po aty*.

Eqerem Vlora e Spiro Koleka, të cilët po merren vesh me njëri-tjetrin në Vlorë.

Më herët, më 9 nëntor, L. Nosi dhe Grigor Cilka i kishin dërguar një letër Eqerem Vlorës ku shprehnin interesimin e tyre rreth përgatitjeve që po bëheshin për organizimin e një kuvendi në Vlorë ku do të bisedohej për qëndrimin e kombit shqiptar në momentet e vështira që po kalonte shteti osman. Nismën e ndërmarre ata e vlerësonin si shumë të rëndësishëm, në dobi të mbrojtjes së të drejtave të kombit shqiptar. “Të epemi me mish e me shpirt pas kësaj veprë... Mbledhja nuk duhet lënë mbas dore dhe ne jemi gati të marrim pjesë”.¹⁰ Sakaq ai i kërkonte E.Vlorës që ta vinte në dijeni se ç’veprime kishin marrë patriotët në Vlorë për përgatitjen e mbledhjes.¹¹ Gjithashtu ata kërkonin që t’i jepnin letër dërguesit gazeta të reja frëngjisht, anglisht, greqisht për t’u informuar rreth të rejave në arenën ndërkombëtare dhe mendimit të të mëdhenjve për çështjen shqiptare.¹²

Përgatitjet për organizimin e kuvendit kombëtar që përfshin elitën politike shqiptare pasqyrohet gjerësisht në dokumentet e ruajtura e të botuara prej L. Nosit. Në mes tyre tërheq vëmendjen telegrami i datës 22 nëntor, të cilin Ismail Qemal Vlora ia dërgon Aqif Pashë Biçakçiut dhe Shefqet Vërlacit. Midis të tjerave ai shkruante: “Sa i madh është rreziku i sotëm aq rëndësi të madhe kanë edhe veprimet që do t’i bëjnë ballë. Në një mbledhje ku do të bisedohen masa të jashtëzakonshme e do të jepet një vendim i premë, e gjindmja e shkëlqesisë suaj është e domosdoshme dhe për këtë nuk mund të mendohet as ndonjë shkak ndalimi”¹³.

Përfaqësia e qytetit të Elbasanit zgjodhi si delegat për në kuvendin e Vlorës Lef Nosin, Mit’hat bej Frashërin, Shefqet Daiun, Aqif Pashë Elbasanin, Dervish Bej Biçakçiun. Delegatët e Elbasanit më datën 25 u nisën për në Vlorë.¹⁴ Në Vlorë Nosi dhe delegatë të tjerë u përfshinë në punë për përfundimin e përgatitjeve për mbajtjen e kuvendit. Veç kësaj ata nuk i ndërprejnë lidhjet për asnjë moment me Elbasanin ku nëpërmjet

¹⁰ *AQSH*, F. 56, V. 1912, D. 61, fl. 2. Letër e L.Nosit e Grigor N. Cilkës drejtuar Eqerem Vlorës, Elbasan, 9.11.1912.

¹¹ *Po aty*.

¹² *Po aty*.

¹³ L. Nosi, *Dokumente historike...*, f. 75. Telegram i I.Qemalit dërguar Aqif Pashës, Shefqet Beut e Irfan Beut, Durrës, 9 vjeshtë e tretë 1328-1912.

¹⁴ *Po aty*, f. 79. Telegram drejtuar Dervish Biçakçiut, nga Elbasani, 12 vjeshtë e tretë, 1328-1912.

telegrameve njoftonin popullin e kësaj treve mbi situatën në Vlorë, në Shqipëri dhe për zhvillimet ndërkombëtare.

Të shtyrë nga situata e përkeqësuar për shkak të përparimit të forcave greke e serbe në territoret shqiptare, delegatët e mbledhur në Vlorë u detyruan të shpallnin pavarësinë e Shqipërisë, pa pritur ardhjen e të mandatuarve të tjerë për të marrë pjesë në kuvend. Ky lajm iu njoftua menjëherë Elbasanit, me anën e një telegrami nga Vlora¹⁵. Në të njëjtën ditë, pra më 28 nëntor 1912, Lef Nosi dhe Shefqet Daiu i kërkonin Mahmut Nedin Hasanit që Elbasani të ngrinte flamurin kombëtar sa më shpejt para se forcat serbe të arrinin aty. Veprimi që i menjëhershëm, flamuri kombëtar u ngrit dhe Aqif Pasha u zgjodh kryetar i qeverisë së përkohshme vendore për Elbasanin.¹⁶

Në një bisedë telegrafike me parinë e Elbasanit, L. Nosi, Qemal Karaosmani, Shefqet Daiu iu përgjigjën një sërë pyetjeve që kishin të bënin me situatën e re politike në vend, për interesin që kanë shfaqur Italia e Austro-Hungaria për çështjen shqiptare dhe zotimet e tyre për të biseduar më fuqitë e tjera për të mbështetur dhe njohur pavarësinë e Shqipërisë. Interesimit të parisë së Elbasanit për delegacionin që do të dërgohej në Evropë dhe anëtarët e tij, L. Nosi iu përgjigj se ata nuk ishin caktuar ende dhe kjo çështje ishte lënë për të nesërmen. Në bisedimet e Kuvendit Kombëtar ku u zgjodhën institucionet e para të shtetit shqiptar, në mbledhjen e datës 30 nëntor, Lef Nosi u zgjodh nënkryetar i Pleqësisë.¹⁷ Në mbledhjen e 5-të, e cila u mbajt më 4 dhjetor ku u zgjodhën emrat e drejtuesve të kabinetit midis tyre u zgjodh edhe L. Nosi, përkatësisht në postin e ministrit të Postës dhe Telegrafës.¹⁸

Lef Nosi e kreu më së miri detyrën e ngarkuar. Ai bëri përpjekje që shërbimi i postës dhe telegrafës të ishte në punë të pandërprerë. Ministri u përkujdes gjithashtu që të vinte në shërbim pullat, stampat (vulat) dhe kartat e reja postale. Në pamundësi për t'i siguruar brenda vendit mjetet e shërbimit postar ai shfrytëzoi rrugët jashtë shtetit të anëtarëve të qeverisë

¹⁵ *Po aty*, f. 97. Telegram i L. Nosit, M. Frashërit, etj., drejtuar kryesisë së qeverisë të përkohshme në Elbasan, Vlorë, 15 vjeshtë e tretë 1328-1912.

¹⁶ *Po aty*, f. 103. Telegramet të shkëmbyera ndërmjet Vlorës dhe Elbasanit, 15/ vjeshtë e tretë 1328-1912.

¹⁷ *Po aty*, f. 180. Mbledhja e dytë e Kuvendit të Vlorës, datë 17/30.11.1912.

¹⁸ *Po aty*, f. 183. Mbledhja e pestë e Kuvendit të Vlorës, 21/4.11.1912.

për të blerë pajisjet e telegrafës shqiptare si dhe predispozicionin e konsullit italian në Vlorë për t'i prodhuar ato në Romë.¹⁹

Veç punës si ministër, L.Nosi u angazhua edhe në përpjekjet e qeverisë së Përkohshme për të shtrirë autoritetin e saj qeverisë në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, pas tërheqjes së ushtrisë serbe²⁰. Interes për qeverinë e Vlorës kishte edhe mbrojtja e Janinës në jug, e cila mbahej e rrethuar nga ushtritë greke. Lef Nosi iu bashkua shqetësimit të I. Qemalit dhe qeverisë për ushtarët shqiptarë të arratisur nga fronti i Janinës. Në thirrjen drejtuar krahinave të ndryshme qeveria e Përkohshme nënvizoi rëndësinë që kishte në ato momente për Shqipërinë, mbrojtja dhe zotërimi i Janinës. “Megjithëse ushtarët tanë luftojnë nën flamurin otoman, prapëseprapë këta duhet ta dinë këtë detyrë dhe rëndësinë që ka Janina për atdheun e tyre”²¹.

Lef Nosi nuk e mbështeti lëvizjen opozitare dhe separatiste të Esad Pashë Toptanit. Në letrat dërguar Gurakuqit në pranverë të 1913-ës ai evidentonte situatën politike të qeverisë së Vlorës për shkak të lëvizjeve të E.Toptanit, i cili, pasi i dorëzoi Shkodrën Malit të Zi, mori premtimin prej tij e Serbisë se do të përkrahej prej tyre për t'u bërë sundimtari i Shqipërisë së Mesme. Me këtë theksonte Nosi, ai synoi për të bërë ëndrrën e tij realitet²². Në letërkëmbimin me Gurakuqin, ai pasqyrore edhe kërkesën e Esad Pashë Toptanit për të mbledhur një kongres në Krujë, i cili do të kishte si qëllim final krijimin e një qeverie të drejtuar prej tij, duke rivalizuar hapur qeverinë e Përkohshme të Vlorës. Ftesave të tij për kongresin i u përgjigjën, sipas Nosit, vetëm Kadri Beu, Myftiu i Tiranës, katër myslimanë dhe një ortodoks i parëndësishëm.²³ Kur pa dështimin e tij, Esati nuk mori pjesë në kremtimin e pavarësisë dhe të flamurit. Prifti katolik, në fjalën e tij e përshëndeti E. Toptanin veçanërisht, por theksoi se nuk do ta pranonin për princ.²⁴ Ndërkohë,

¹⁹ *AQSH*, F. 34, V. 1913, D. 36, fl. 29. Letër e L. Nosit drejtuar L. Gurakuqit, Vlorë, 23.5.1913; *Po aty* F. 32, V. 1913, D. 53, fl. 11. Letër e Nosit drejtuar Sh. Daiut dhe Idhomene Kosturit, Vlorë, 14 prill 1913.

²⁰ *Po aty*, F. 32, V. 1913, D. 53, fl. 11. Letër e Nosit drejtuar Sh. Daiut e Idhomene Kosturit, Vlorë, 14 prill 1913.

²¹ *Po aty*, F. 245/III, D. 4, fl. 1. Thirje e qeverisë së përkohshme të Vlorës drejtuar krahinave të ndryshme të Shqipërisë, Vlorë, 16/29 janar 1913.

²² *Po aty*, F. 34, V. 1913, D. 36, fl. 31. Letër e L. Nosit dërguar L. Gurakuqit në Romë, Vlorë, 23 maj 1913.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*.

Pashai dhe mbështetësit e tij, në bashkëpunim me myftiun e Tiranës kishin nisur një propagandë denigruese ndaj kabinetit të Vlorës, duke thënë “ shihni se në ç’ dorë ka rënë vendi.”²⁵

Lef Nosi vlerësonte punën që Mustafa Merlika (Kruja) kishte bërë me Esat Pashën, duke mbrojtur qeverinë e Vlorës dhe duke refuzuar bashkëpunimin më të, ç’ka sipas tij kishte ndikuar që për momentin Esat Pasha të linte mënjandë idenë e tij. Këtë Nosi e vërtetonte edhe me fushën e lirë të komunikimit që qeveria e Përkohshme pati me Tiranën, Krujën e Shijakun, të cilin Pashai nuk e pengoi. Vendimi i Fuqive të Mëdha për largimin e ushtrive osmane nga Shqipëria, largoi edhe gjysmën e forcës të komanduar nga Esati. Kështu ai mbeti pa mbështetje brenda vendit por edhe jashtë pasi Roma dhe Austro-Hungaria njihnin qeverinë e Vlorës si përfaqësuese të Shqipërisë²⁶. Në këto kushte, Esat Pashë Toptani pranoi propozimin e Ismail Qemalit, duke marrë postin e ministrit të Punëve të Brendshme në qeverinë e Përkohshme të Vlorës. Letërkëmbimi i Nosit me Gurakuqin vijoi edhe në qershor 1913. Në një letër dërguar nga Elbasani, me sa duket në përgjigje të propozimit të Gurakuqit për përdorimin e armëve në mbrojtje të qeverisë së Përkohshme, Nosi shprehej se “situata nuk kishte arritur deri në atë shkallë sa të rrokim armët e të përgjakemi vlla me vlla”. Sipas tij qeveria e Vlorës duhej të tregohej më e kujdesshme sepse “po të kishim patur më shumë kujdes, punët nuk do të venin deri në këtë shkallë”²⁷. Kundërshtarin, propozonte ai, duhet ta luftojmë me argumente të shëndosha me anë të pendës e jo të flakës.²⁸ Ai nuk pranonte dhe e konsideronte të turpshme dhe mëkat “t’i trashëgojmë kombit grindjen dhe gjakderdhjen”. Në këtë situatë, Nosi i rekomandonte Gurakuqit që me anë të shtypit duhej demaskuar veprimtaria e dëmshme e E.Toptanit. “Me fakte, shprehej ai, duhet t’i provohet popullit se ai është fajtor dhe kërkon prishjen e qeverisë kombëtare dhe punon për hesap të armiqve për të marrë prej tyre të holla”.²⁹

Konsequent në krah të qeverisë së Përkohshme të Vlorës edhe në muajt e fundit të ekzistencës së saj Nosi nuk u pajtua me veprimtarinë në

²⁵ *Po aty*, F. 34, V. 1913, D. 36, fl. 31. Letër e L. Nosit dërguar L. Gurakuqit në Romë, Vlorë, 23 maj 1913.

²⁶ *Po aty*, fl. 29. Letër e L. Nosit dërguar L. Gurakuqit në Romë, Vlorë, 23 maj 1913.

²⁷ *Po aty*, fl. 32. Letër e Nosit drejtuar Gurakuqit në Vlorë, Elbasan, qershor 1913.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ *Po aty*.

rritje kundër qeverisë së Vlorës të Esat Toptanit me synimin për të marrë e për të ushtruar kompetencat e saj. Ai dhe paria e Elbasanit nuk i u përgjigjën thirrjes së Pashait për krijimin e Pleqësisë së Shqipërisë së Mesme. Me anën e një letre, Nosi njofton Gurakuqin se këtij autoriteti i mungonte mbështetja. Sipas tij, mitingjet e organizuara në sanxhakun e Durrësit ishin “pa rëndësi se përveç se u bënë me pahir nuk patën as shumicë”.³⁰

Veprimtaria gjalluese e Esat Toptanit, ardhja e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe vendosja e tij në Vlorë, me detyrën e organizimit të shtetit shqiptar, e kufizuan aktivitetin e qeverisë së Vlorës, e cila më 22 janar 1914 dha dorëheqjen. Në këtë moment shumë të vështirë Lef Nosi dhe Petro Poga më 23 janar i dërgojnë një letër Ismail Qemalit në Vlorë. Aty shprehet dëshpërimi i tyre për fatin e qeverisë së Vlorës. “kujtimi i ditës së shenjtë theksonin ata ku në mes të mbledhjes së kombit proklamuat atdheun e dashur përpara botës të lirë e independent dhe bashkëpunimi ynë në mes kaq vështirësish e pengimesh në këto 14 muajsh do të mos na dalë nga mëndja sa të jetë jeta jonë.”³¹ Ata i shprehën dëshirën plakut të urtë të Vlorës që largimi i tij nga qeverimi i atdheut të ishte sa më i shkurtër “ e të ktheheni përsëri në gji të atdheut për të kryer veprën e madhe që nisët më 28 nëntor 1912. Udhëtimi që bëni sot qoftë i mbarë e sjelltë lirinë e vërtet në Shqipëri.”³²

³⁰ *Po aty.*

³¹ *Po aty*, F. 20, V.1914, D. 17, fl. 11. Letër e L. Nosit dhe P. Pogës drejtuar I.Qemalit, Vlorë, 23 janar 1914.

³² *Po aty.*

